



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT FIER/VLORË/GJIROKASTËR
SEKTORI INSPEKTIMIT MJEDISOR

Nr. 1833/ Prot.

Fier, më 30.06.2025

Lënda: Vënie në dispozicion

ALBPETROL SH.A
Fier Patos L.29.Marsi

Për dijeni:


KOMISARIATIT TË POLICISË VLORË
Vlorë

Në mbështetje të Ligjit Nr. 99/2024, datë 12.9.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.10431 Datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, Ligjit Nr.9115 Datë 24.07.2003, i ndryshuar, "Për Trajtimin e Ujërave të Ndotura", Ligjit Nr.10463 Datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" i ndryshuar, Ligjit Nr.10279 Datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative" dhe VKM-së Nr.568 datë 17.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" po ju vëmë në dispozicion:

Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

Formati Nr. 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT FIER, VLORE, GJIROKASTER

VENDIMI I NDËRMJETËM
PËR MARRJEN E MASËS URGJENTE

Datë 30/06/2025

Emri i subjektit ALBPETROL SH.A NIPT J82916500U

Adresa/vendndodhja : Patos L.29.Marsi Dega: Vlore, Vllahine, Stacioni Amonice, Fshati
Mallkeq, Njesia Administrative Vllahine, Bashkia Selenicë, vendburimi Gorisht-Kocul

Emri i punëdhënësit: Eltar Deda

Në bazë të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, merret masa urgjente si më poshtë:

Ne kuader të parandalimit të ndotjes së mjediseve ujore pritese, me qëllim mbrojtjen e perroit dhe me tej të lumit "Vjosa" nga ndotja e ujerave teknologjike të perzier me lende hidrokarbure, si dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe ujerave. Subjekti Albpetrol të ndërpres në mënyrë të menjehershme çdo rrjedhje të ujrave teknologjike të perziera me hidrokarbure, që vijnë nga argjinaturat e depozitave apo tubacioneve të cilat me pas perfundojnë në perrua dhe me pas në lumin "Vjosa".

Kohëzgjatja e afatit të masës urgjente:

12:00 30.06.2025

(ora, data e fillimit)

12:00 30.07.2025

(ora, data e përfundimit)

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

...

* Ky vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente njoftohet brenda 24 orëve.
**Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij. Ankimi i veçantë paraqitet pranë degës territoriale të inspektoratit shtetëror përkatës.